

## Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	
Titulli i kontratës:	Krijimi i video-storieve të suksesit për punën e KCSF-së dhe grantistëve

### HYRJE

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

### FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMIT

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile synon të angazhojë kompani e cila do të prodhojë video storie të suksesit që do të plasohen në rrjete sociale dhe ueb faqe lidhur me punën e KCSF-së dhe grantistëve që mbështeten përmes skemave të ndryshme brenda programeve të KCSF-së.

Për të arritur deri tek përzgjedhja, kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë propozimet e tyre teknike dhe financiare, ku përshkruhet qasja, metodologjia dhe plani i punës për kryerjen e shërbimit, mbi të cilat do të përzgjidhet kompania fituese.

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e drejtpërdrejtë të Zyrtares për Marrëdhënie me Publikun/Komunikim, ofruesi/kontraktori i shërbimit pritet që brenda periudhës kohore **4 shtator-30 nëntor 2023** të:

- Zhvillojë konceptin dhe skenarin e përgjithshëm për prodhimin e 10-15 video storieve të suksesit 2-3.5 minutësh.
- Intervistojë personazhet e përzgjedhura për videon (pjesëtarë të shoqërisë civile, grantistë, staf i KCSF-së, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, donatorë etj.);
- Të krijojnë xhirime/pamje mbuluese të përshtatshme për secilën storie të suksesit në terrene të ndryshme brenda Kosovës;
- Zhvillojë narrativen dhe skenarët e video storieve të suksesit;
- Përfshijë titrat në gjuhën angleze dhe serbe në video;
- Ofrojë të gjitha kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e videove të cilësisë së lartë duke përfshirë: xhirim/kamerë filmike, ndriçim profesional/HMI, tonist zëri, teleprompter, gazetar/e për intervista, video-editim të avancuar, postproduksion dhe efekte vizuale.
- Dorëzojë listën e pajisjeve që do të përdoren në prodhimin e video-storieve.

- Prodhojë videot storiet e suksesit duke u bazuar në udhëzimet e marra nga zyrtarja për Marrëdhënie me Publikun/Komunikim;
- Dorëzojë të gjitha informacionet lidhur me këtë projekt dhe të gjitha draftet/versionet e videove, të cilat do të mbesin pronë e KCSF-së, duke i ruajtur të drejtat ekskluzive mbi të drejtën e autorit dhe përdorimin e ardhshëm.

#### **AFATI KOHOR**

Afati i fundit kohor për finalizimin e video storieve është 30 nëntor 2023. Megjithatë, videot konsiderohet që kanë përfunduar vetëm pas vlerësimit dhe aprovimit përfundimtar nga KCSF.

<b>Detyrat:</b>	<b>Afati kohor:</b>
Takimi fillestar mes KCSF-së dhe kompanisë së kontraktuar	<b>5 shtator 2023</b>
Dërgimi i konceptit dhe skenarit të përgjithshëm për prodhimin e 10 video storieve të suksesit 2-3.5 minuta	<b>5-12 shtator 2023</b>
Intervistimi i pjesëmarrësve të përzgjedhur dhe sigurimi i pamjeve për mbulimin e storieve në terren	<b>12-30 shtator 2023</b>
Zhvillimi i narrativës dhe skenarët specifik për 10-15 video	<b>9 tetor 2023</b>
Prodhimi i 5-7 video storieve të para bazuar në udhëzimet e marra nga KCSF/ zyrtarja për Marrëdhënie me Publikun-Komunikim.	<b>9-31 tetor 2023</b>
Prodhimi i 5-8 video storieve të fundit bazuar në udhëzimet e marra nga KCSF/ zyrtarja për Marrëdhënie me Publikun-Komunikim.	<b>31 tetor-30 nëntor 2023</b>

#### **KËRKESAT PËR KUALIFIKIM**

KCSF-ja do t'ia besojë realizimin e kësaj pune një kompanie. Një komision i përzgjedhur nga KCSF do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kompanisë. Kompania duhet të ketë të gjitha kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e video storieve, përfshirë: xhirim/kamerë filmike, ndriçim profesional/HMI/LED, tonist zëri profesionist, video-editim të avancuar, postproduskion dhe efekte vizuale, teleprompter.

Gjithashtu, kompania duhet të ketë persona kompetent për kryerjen e detyrave duke përfshirë një gazetar/e për intervista dhe regjisor filmi/TV. Kompania duhet të bëjë insertimin dhe përpunimin e pamjeve dhe videove eventuale nga arkivat e grantistëve, përgatitjen e pyetjeve dhe narracionit, voiceover si dhe titrim.

#### **PROPOZIMI FINANCIAR**

Çmimi në propozimin financiar duhet të kuotohet në euro. Çmimet duhet të kuotohen pa përfshirë TVSH-në dhe shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

## **DËSHMITË DHE KAPACITETI PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TEKNIKE DHE PROFESIONALE**

Kompanitë e interesuara duhet të demonstrojnë një ekspertizë të fortë në fushat e mëposhtme:

- Përvojë e dëshmuar në zhvillimin e video storieve të suksesit apo videove promovuese;
- Përvojë e shkëlqyer dhe e dëshmuar në detyra të ngjashme, mundësisht në projekte të kësaj madhësie dhe fushëveprimi.
- Të ofrojë CV të stafit profesional: regjisor, kameraman, gazetar/e, montazher.

## **DEKLARATA NËN BETIM NGA PERSONI JURIDIK/FIZIK DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT**

Të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin Deklaratën nën betim për kriteret e përjashtimit dhe parandalimi i konfliktit të interesit (shih Shtojcën 2), të nënshkruar nga përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose personi fizik dhe duke cekur datën, duke deklaruar se ata nuk janë në një nga situatat e përjashtimit të renditura në Shtojcën 2.

## **VLERËSIMI DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES**

Ofertat do të vlerësohen duke marr parasysh kriteret e mëposhtme të vlerësimit (100 pikë):

- 1.Kapacitetet për përmbushjen e detyrave duke paraqitur kualifikimet e ekipit të propozuar (CV e ekipit) si dhe listën e pajisjeve profesionale për realizim të punës- 30 pikë
- 2.Puna e paraqitur përmes portfolios së kompanisë duke dëshmuar përvojën në realizimin e videove të ngjashme dhe referencat- 40 pikë
3. Oferta financiare (çmimi më i ulët) – 30 pikë

## **TERMAT DHE KUSHTET**

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në dosje të tenderit ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen. KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë. KCSF rezervon të drejtën për të negociuar me një ose disa ofertues të listës së ngushtë, pas vlerësimit fillestar të ofertave të dorëzuara. Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF. KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë. Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkojë takim për të ndihmuar procesin e vlerësimit.

## **APLIKIMI**

Të gjitha aplikacionet të dërgohen në adresën elektronike [tender@kcsfoundation.org](mailto:tender@kcsfoundation.org), më së largu deri më **28 gusht 2023, ora 23:59.**